



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2294 Prot.

Vlorë me 29 /10 /2019

Vendim

Nr. 5 datë 23.10 2019

**MBI MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE TË SHPENZIMEVE;
NDARYSHIM BRENDA BUXHETIT TË MIRATUAR ME VKQ NR 10 DATË 25/06/2019 PËR
PROJEKTET ME FINANCIM TE HUAJ NË BUXHETIN E VITIT 2019. KAP (2)**

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për përgatitjen e rritjes së planit të të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe ndryshim brenda buxhetit për kalimin e fondeve të parashikuara kap 5 për projektet me financim të huaj, kalojnë kap 2 në buxhetin e vitit 2019, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 77 .
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 99/2018 dt. 03/12/2018 " për buxhetin e vitit 2019".
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr.1. datë 17.01.2019 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019". Pika 21- 29.
- Udhëzimin nr. 8 datë 17.2.2003 "Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj",
- Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 47, datë 20.12.2018 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019",
- Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 10, datë 25.06.2019 "Mbi miratimin e ndryshimit brenda buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019".
- Shkresa numër 17841/1 prot datë 14.10.2019 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave te Germa A. në vlerën 29023 / mijë lekë, për projektet me financim të huaj IPA.
2. Të miratojë rritjen e planit të shpenzimeve te Germa B. në vlerën 29023 / mijë lekë, për projektet me financim të huaj IPA sipas tabelës bashkangjitur.
3. Të miratojë pakësimin e të ardhurave të veta kapitullin 5(pesë) , të shtohen në kapitull 2(dy) në vlerë 1092 mijë lekë për projektet me financim të huaj për performancë.

- 2
4. Të miratojë pakësimin e shpenzimeve kapitull 5(pesë) ,të shtohen në kapitull 2(dy) në vlerë 1092 mijë lekë Art (602) për projektet me financim të huaj për performancë.
 5. Shpenzimet e pikës 2 dhe 4 do të përdoren sipa pasqyrës bashkëlidhur.
 6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike Shërbimeve,dhe Zëdhënësja Këshilltarja për projektet komunitare.

4.Drejtori Ekonomik pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuar nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për cdo muaj

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas *ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*.